REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

## PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE

## SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

**Lënda:Ekonomi e thelluar** **Varianti A**

- ***Pyetjet me zgjedhje***

| Numri i Pyetjes | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Përgjigja e saktë | C | C | A | C | C | C | C | D | D | C |

- ***Pyetjet me zhvillim***

❖ Në skemen e paraqitur të testit ,për pyetjet nga 11-20 jane dhene modele përgjigjesh të sakta.Nxënësit do të marrë pikët e merituara edhe nëae ai ka dhënë përgjigje me fjalë të tjera por që janë brënda konteksit të pergjigjes se saktë.
❖ Në pyetjet me zhvillim,ku kërkohen dy,tre apo katër nga të gjitha përgjigjet e sakta të mundshme ,në rast se nxënësi ka dhënë aq përgjigje të sakta sa i kërkohet nga pyetja ,atëhere atij do ti jepen te gjitha pikët maksimale me te cilat është vleresuar pyetja.
❖ Nxenesi do të marrë aq pikë sa është vleresuar pyetja edhe ne rast se ai ka dhënë më shumë pëërgjigje të sakta nga sa i kërkohen.

**11.** **3 pikë**
a. Elasticitet i kërkesës në lidhje me çmimin **do të rritet** sepse më shumë Zëvendësues do të ketë në treg *1pikë*
b. Elasticitet i kërkesës në lidhje me çmimin **do të ulet** sepse më pak Zëvendësues do të ketë në treg. *1pikë*
c. Elasticitet i kërkesës në lidhje me çmimin **do të rritet** sepse pjesa që ze në buxhetin tonë shpenzimi për këtë të mirë është e konsiderueshme. *1pikë*

**12.** **3 pikë**
a)dobia qe merr konsumatori nga konsumimi i njësive te njëpasnjëshme të një malli,zvogëlohet nëse rritet konsumi i përgjithshem i mallit ,ndërkohe që konsumi i të gjitha mallrave te tjerë qendron i pandryshuar. (Ose kur rritet sasia e konsumit te nje malli ,dobia marxhinale e njësisë se fundit të konsumuar vjen vazhdimisht duke rënë ,kur konsumi i mallrave te tjerë qendron i pandryshueshëm.) *1pikë*
b) mat ndryshimin sasisë së kërkuar /ofruar kur ndryshojnë te ardhurat e konsumatorit. (eshte e sakte edhe nese nxenesi shenon formulen: Ey $\Delta$**Q** /$\Delta$Y ( te ardhurat shenohen edhe me R) *1pikë*
c) është një aktivitet gjatë të cilit individët organizojnë,drejtojnë dhe marrin përsipër rreziqet e drejtimit të një biznesi. Përgjigjja quhet e saktë edhe nëse nxënësi shkruan që sipërmarrja është një proçes dinamik i vizionit ndryshimit dhe krijimit . *1pikë*

**13.** **3 pikë**
a) sasia fitim maksimizuese është 5 njësi produkti 1pikë
b) firma del me fitim normal 1pikë
c) firma duhet të vazhdojë prodhimin *1pikë*
* fillimisht nxënesi do te gjejë koston mesatare totale .ATC =AFC+AVC. Më pas gjen TC=ATC*Q

*Gjejmë koston marxhinale MC= ΔTC /ΔQ

*Dimë që në konkurencën e plotë .P=MR=AR. keshtu MR ë shte 22 njësi.

*Gjejmë pikën ku maksimizohet prodhimi MR=MC.=Q5

* Gjendet fitimi i firmës: ∏=P-ATC ∏ = 22-22=0 .kjo tregon se firma duhet te vazhdojë prodhimin sepse firma del me fitim normal.

* Nxënësi mund ta zhvillojë ushtrimin edhe në formë tjetër duke Gjetur TR =P*Q.

*Përcaktojmë fitimin e firmës ∏ = TR-TC per te parë nëse firma duhet te vazhdojë prodhimin ne sasinë ku MR=MC .

**14.** **3 pikë**

| Y (industrial) | X (bujqesor) |
|---|---|
| 0 | 20 |
| 5 | 15 |
| 10 | 10 |
| 15 | 5 |
| 20 | 0 |

a) Ndërtohet tabela. Më pas ndërtohet grafiku *1pikë*
b) tregon kombinime te mundshme por jo eficente *1pikë*
c) tregon prodhim me te madh por e paarritshme sepse nuk ka burimet e mjaftueshme per prodhim ne kete nivel. *1pikë*




**15.** **3pikë**

Pika merret kur nxenesi perdor shembullin konkret te eksternalitetit.psh:
a)ndertesat historike te restauruara.Kerkimi per teknologji te reja,etj *1pikë*
b) nje koncert ne pallatin e kongreseve me bilete i perjashton te tjeret nga kjo e mire. *1pikë*
c) nje koncert ne shesh ose peshkimi ne det nuk i perjashton te tjeret nga kjo e mire *1pikë*

**16.** **3pikë**

a) zhvendosja që shkaktohet nga rritja e konsumit. (në rastin kur qeveria ul taksat, popullsia rrit konsumin) *1pikë*
b) Zhvendosja që shkaktohet nga investimet e firmave
c) Zhvendosja që shkaktohet nga blerjet qeveritare( një rritje në blerjet qeveritare për mbrojtjen dhe rrugët, e zhvendos djathtas) *1pikë*
d) Zhvendosja që shkaktohet nga eksportet neto ( për rimëkëmbjen e ekonomisë, vendet fillojnë të blejnë mallra nga vendet e BE duke rritur kërkesën tërësore) . *1pikë*

**17.** **3pikë**
a)niveli i GDP rritet nga Q1 ne Q2 *1pikë*
b) niveli i cmimeve nuk ndryshon. *1pikë*
c)Paraqitet grafiku.(piket do ti quhen nxëenesit edhe nëse nx ben zhvendosjen e lakores nga djathtas majtas por ka te qarte qe ne kete rast ndodh ulja e GDP) *1pikë*
niveli cmimeve




**18.** **3pikë**
a) embargo *1pikë*
b)subvencionet *1pikë*
c) pengesat jotarifore *1pikë*

**19.** **3pikë**
a) aftësia për të plotësuar nevoja të veçanta *1pikë*
b) aftësia për t'iu përshtatur ndryshimeve *1pikë*
c) pavarësia *1pikë*
d) fitimi i pritur *1pikë*
e) hyrja e lehtë në treg *1pikë*
f) kontakti shumë personal me klientin *1pikë*

**20.** **3pikë**
Nxënësi do të vlerësohet nëse përmend një nga këto aspekte.
a) periudha afatshkurtër *1pikë*
b)periudhë afatgjatë *1pikë*
c)sasia output *1pikë*
d)sasia input *1pikë*
g)teknologjia. *1pikë*